



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipal Kačanik  
Kuvendi i Komunës  
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr.060/01-8863/26  
Kaçanik, 16.04.2026

### FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e IV (katërt) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2026.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës, në sallën e komiteteve të kuvendit, me 23.04.2026 (e enjte), më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit  
Selajdin Troni

Në mbledhjen e IV (katërt) të Rregullt të KPF të datës 23. 04.2026, do të shqyrtohet ky:

### **REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti tremujor financiar për periudhën: Janar-Mars 2026;
3. Propozim Vendim për themelimin e Komisionit komunal të aksionarëve për NPK “Stacioni i Autobusave” SH.A.- Kaçanik;
4. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Kaçanik i Vjetër.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipal of Kaçanik**

**01Nr.60/01-6399/26**  
**Kaçanik, 26.03.2026**

## **PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e **III (tretë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e 8 e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 26.03.2026, në ora 11:00. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e KK, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF prej 7 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 7 anëtarët-të gjithë: Selajdin Troni, Lejla Çaka-Muhaxheri, Bashkim Krasniqi, Kadrije Lika-Troni, Ernesta Krasniqi, Ardita Rrahmani, Kjani Zeneli. Nga Ekzekutivi i Komunës, morën pjesë: Nënkrjetari i Komunës- Xhelal Dema, Drejtorët e Drejtorive: Valdrin Dogani-DBF, Urata Sopa-DAP, Lumnije Demnika-Selmani-DSHMS, Gazmend Bunjaku-DA, ndërkaq nga zyrtarët: Arianitë Bajrami dhe Makfire Malsiu.

Mbledhjen e kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit.  
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Lartë për Punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit- Selajdin Troni, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, prezentë janë 7 anëtarët-të gjithë, materialin e keni marrë, e hapi mbledhjen e III (tretë) të rregullt të KPF-së për vitin 2026, data 26.03.2026.

### **REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Begracë, Kaçanik, Nikaj, Elezaj, Kotlinë dhe Ivajë;
3. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2024.

Me material iu është dërguar edhe Rregullorja e punës së KK, ku janë përcaktuar minutat për çështje të caktuara dhe replika. Sipas rregullores, anëtarët e KK mundën me bërë pyetje, por jo edhe kërkesat. Kërkesat i adresoni të Ekzekutivi i komunës, në formë të shkruar, apo mund të shkoni në Zyre të kryetarit apo të drejtoria përkatëse, megjithëse në mandatin e kaluar dhe deri tani, ne kemi bërë përjashtime. Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin:

**znj. Kadrije Lika Troni:** Për anëtarët e ri, mundeni me ua sqaruar. A është obligim i drejtorit me na dhënë përgjigje, se drejtorët nuk po janë në gjendje me na u përgjigjur?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtorët mundën me u përgjigjur në pyetjet që i kanë të dhënat. Për ato pyetje e kërkesa që nuk i kanë të dhënat, përgjigjet i merrni me shkrim, se nuk dihet çfarë pyetje mund të ngritën, që me i pasur të dhënat drejtori.

**znj. Ardita Rrahmani:** Unë i kam përcjellë mbledhje të 2-3 komunave, në komunën tonë epët hapësirë me tepër për diskutime.

**Nënkryetari i Komunës-Xhelal Dema:** Ne mundemi me pasur mospajtime, mendime ndryshe, por qëllimi është për mirë. Pyetjet mundeni me i adresuar në mbledhje, ndërkaq përgjigjet jo të gjitha mundën me u dhënë aty për aty. Për ato që nuk kanë të dhëna, ekzekutivi i komunës në mbledhjen vijuese, përgjigjet i japin me shkrim.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Rregullorja nuk është e përditësuar nga viti 2008, rregullorja ka mangësi, se duhet me u paraqitur debatet publike, pikat e rendit të punës, transparenca ndaj qytetarëve, procesverbalet, duhet me qenë në rregullore të punës së KK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse rregullorja ka ardhur nga niveli qendror si model, nuk e di sa mundemi me bërë ndërhyrje. Ne nuk mundemi me iu përmbajtur rregullores në tërësi, por se paku me iu përafuar zbatimit të saj, megjithëse ndonjëherë mundemi me bërë përjashtime. Në KPF i kemi 3 pika, pika 2 është me diku 15 nënpika. Rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

#### **Aprovoj**

#### **Rendin e punës në përbërje prej 3**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar të KPF u aprovua pa vërejtje. Konstatohet se KPF,

#### **Aprovoj**

**Procesverbalin e mbledhjes II (dytë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 24.02.2026/ Lënda: 01Nr. 060/01-4294/26.**

2.Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Begracë, Kaçanik, Nikaj, Elezaj, Kotlinë dhe Ivajë;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Nga 10 minuta iu lejohet me diskutuar për çështjen e caktuar, ndërkaq 2 minuta replikë. Nuk do të thotë që nuk u japim fjalën edhe ndonjëherë tjetër, por me u munduar me mbajtur njëfarë rendi si në rregullore.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Lidhur me këtë pikë, kërkoj me na dhënë sqarime të nevojshme drejtori i DUKMM.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtor, nëse keni mundësi, na jepni sqarime të pika 2, Shpallja me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Begracë, Kaçanik, Nikaj, Elezaj, Kotlinë dhe Ivajë;

**z. Korab Krasniqi:** Pyetjet dhe kërkesat që i kam pasur nga Kadrije Lika Troni dhe Hëset Malsiu, iu kam përgjigjur. Ata që kanë probleme me emaile, është diçka tjetër. Për çdo paqartësi tjetër, mundeni me ardhur pas mbledhjes në zyrën time. Pika që është temë debati, DUKMM gati se çdo ditë pranon kërkesa për shpallje me interes të pronave të tyre. Në këtë rast, janë trajtuar disa kërkesa që janë bërë kohë me parë. Ato që janë me të arsyeshme, i kemi adresuar KK. Nëse nuk ka d akordim, nuk do të thotë se nuk mundemi me tërhequr ndonjë pikë, se siç po e shihni, krejt këto janë pika të veçanta. Ne jemi munduar me iu bërë zgjidhje qytetarëve që kanë problem me qasjen në pronën e tyre, se e ka ndërtuar objektin pa pasur rrugë, apo e ka ndërtuar objektin afër rrugës dhe nuk mundet me legalizuar. Secili pronë e ka numrin e PK të pronës së personit fizik, krejt janë prona në emër të personave fizik, janë në lëndë secila parcelë dhe pjesa që mendohet në të ardhmen për këmbim. Nëse ka ankesa, përkundër se e shpallim me interes një pronë, mundemi mos me përcjellë për këmbim, se duhet një vendim i kryetarit dhe një vendim i ministrisë, për me votuar këmbimin. Kjo është faza e inicimit të procedurës për shpallje me interes. Për çdo vërejtje, sugjerim, jam i hapur, nëse ka diçka, deri në mbledhje të KK, kryesuesi ka të drejtën me tërhequr pikën, për me shqyrtuar në mbledhjen vijuese.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutuam edhe me herët, për herë tjera, nënpikat si kjo, me u bërë pika të veçanta. Janë 15 pikë në kuadër të kësaj pike, unë e kam obligim me i lexuar të gjitha, që me ditur qytetarët se cilat prona jemi duke shpallur me interes.

**z. Korab Krasniqi:** Nëse mundet me u bërë ky ndryshim ligjërisht, unë i bëjë për KK të veçanta, se është me mirë edhe për vlerësimin e tyre në ministri.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne e patëm një çështje që na u kthye në rishqyrtim, për faktin se ishin 2 pikë në kuadër të një pike. Mos të penalizohet dikush, pse nuk është i përgatitur materiali në formë të veçantë. Ne i ndamë pikët edhe të serat, për mos me pasur probleme të vlerësimit.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Kërkesat janë personale të individëve. A ka komuna plan urbanistik, që me shtjelluar me administratorin e fshatit, se a kanë ndonjë ide tjetër, e jo me i paraqitur kërkesat e individëve të caktuar, pa pasur ndonjë plan, se unë nuk po shoh që ka plan komuna. Komuna e ka marrë iniciativën për me shpallë interes publik pronën, në bazë të kërkesave të qytetarëve. Këtu shihet se ka edhe prona në bashkëpronësi, të cilat mund të na paraqesin problem, se mund t'iu lindin mosmarrëveshje në mes tyre.

**z. Korab Krasniqi:** Vlerësimin e bënë ministria. Për pronat që janë në bashkëpronësi, pa e pasur pëlqimin e tyre, ne nuk mundemi me iniciuar çështjen. Në dosje i kemi pëlqimet me nënshkrime, kartat e identitetit, ndërkaq i kemi hequr për shkak se janë të dhëna të mbrojtura. Nënshkrimi është personal i secilit dhe nuk mundet dikush tjetër me dhënë nënshkrim në vend të tjetrit. Procedura është krejt në rregull, e vetmja që mundemi me diskutuar, është nëse ka ndonjë reagim publik. Ne jemi duke përgatitur me shpallë me interes publik, rrugën Stagovë, pjesa kah tuneli, që kalon nëpër prona private, pa kërkesë të banorëve, normal se qytetarët përballën tani me kërkesa me të mëdha për pronat e tyre.

**z. Kjani Zeneli:** Unë disa prona që shpallen me interes i kam të qarta, disa jo, se ne nuk jemi të fushës me i kuptuar. Është mirë që shpallen me interes këto prona, me ua zgjidhur problemin qytetarëve. Për hera tjera me na ardhur me ortofoto shpalljet me interes të pronave, që t'i kuptojmë me mirë pronat, e jo me na ardhur vetëm me vizatime, se në këtë

formë, ne që nuk jemi të fushës nuk i kuptojmë sa duhet ose për mbledhje të KK të shpjegohen me në detale përmes televizionit në sallë.

**znj. Ardita Rrahmani:** Pajtohem me parafolësin që po i kërkon ortofotot, është e drejtë e tij, ndërkaq me u thirrur në atë që nuk jemi ekspertë për çështje të fushës, ne jemi anëtarë të KK, nuk mundemi me qenë të shumë fushave të caktuara. Detyra e një anëtari të KK, është me i trajtuar çështjet që na adresohen, ndërkaq ne si subjekt politik, kemi njerëz të fushave të caktuara që na i sqarojnë, e jo me ardhur në KK me prituri sqarime vetëm prej një drejtori cilido që të jetë. Po pajtohem me atë që po kërkon ju, por nuk po pajtohem me çështjen që thoni se nuk jam ekspert i kësaj lëmi, e me na u sqaruar këtu. Ne jemi anëtar të KK, marrim një pagë bukur të mirë që vijmë këtu njëherë në muaj. Ne pasi të marrim materialin, mundemi me u konsultuar me njerëz profesionist të fushës së caktuar, për me marrë mendim konkret. Kjo vlen edhe për mua, dhe për secilin anëtar të KK.

**z. Kjani Zeneli:** Ju mirë po thoni, ne nuk mundemi me qenë të fushave të caktuara, dhe ne duhet me u konsultuar me njerëz të fushave të caktuara. Unë jam konsultuar, por ka edhe defekte këtu që i potencoj edhe kryesuesi, janë shumë pika në një pikë, që është me e vështirë me kuptuar secilën pronë se çka është duke marrë apo dhënë komuna. Ne kemi pasur raste kur prona iu ka marrë individin dhe nuk ka qenë vlere e barabartë dhe është votuar, por shumica po e shfrytëzoni kuotën e votës dhe po kalon çështja.

**znj. Ardita Rrahmani:** A ka qenë në mbledhjen e kaluar ky rast?

**z. Kjani Zeneli:** Jo, një mbledhje me herët. Ne duhet me ditur me i raportuar qytetarit, se ne këtu kemi ardhur me votat e qytetarëve, nuk kemi ardhur këtu për interesat tona. Ne duhet me i pasur të qarta çështje, seancat po mbahen live, ne po ngritim dorën, pa ditur se çka po votojmë, kështu që t'i kemi çështjet pak me të qarta, edhe pse kam respekt shumë për drejtorin. Unë e kam marrë një përgjigje nga DA shumë të saktë, edhe pse jo e kënaqshme, se unë isha me ia mundësuar nxënësve që studiojnë në komunat tjera, transportin. Unë po dua me qenë me të qartë, që qytetari të kuptojë se ne çka jemi duke punuar ne këtu.

**znj. Ardita Rrahmani:** Unë nuk jam kundër debatit, por të paktën me arritur një konkluzion kur të bëjmë debat. Në mbledhjen e fundit, e kemi pasur edhe çështje të këmbimit të pronave, këmbimi është bërë në raport të barabartë. Ne të njëjtat kërkesa i kemi adresuar edhe në legjislaturën e kaluar dhe në këtë legjislaturë. Seancat janë publike, mundemi me i rikthyer nëse ka pasur harresa, të njëjtën çështje i kam kërkuar edhe unë nga pushteti, se edhe unë jam e votuar nga disa qytetarë. Fuqinë e votës nuk mendoj se e ka askush të plotë këtu. Unë nuk e kam problemin a jam në pushtet apo opozitë, se kur e shoh që po preket interesi publik, e ndajë mendimin tim si votoj. Unë nuk kam kurrfarë interesi me ardhur këtu me ngritur dorën, unë nuk e njoh asnjë nga 15 pronarët e pronave, por në bazë të argumenteve e vlerësoj dhe e jap mendimin tim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk e pati qëllimin të fuqia e votës që nuk po e mbrojmë, por qëllimi është se po duhet me ditur pak me tepër qytetarët, se për 15 parcela, nuk është e lehtë me ditur saktë se çka po shpallet interes. Ne kemi mundur me trajtuar secilën pronë veç e veç për secilën pronë, a trajtojmë kështu komplet dhe me i adresuar në KK.

**z. Korab Krasniqi:** Për KK u kuptuam me i shqyrtuar veç e veç. Për pjesën e vlerësimit, i përgjigjem Kjanit se nuk kalon asnjë pronë që nuk është e barasvlerëshme. Vlerësimin e

bënë ministria, nëse nuk janë të barasvlershme ato prona, procedura nuk shkon tutje. Vlerësimet e MF kanë qenë në lëndë, kur të shqyrtohet këmbimi, keni me i pasur pronat që shpallet interes dhe ato që jepen në këmbim, se kjo i shërben informimit qytetarë dhe anëtarëve të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** A po doni me i trajtuar këtu një nga një.

**z. Korab Krasniqi:** Propozoj që pikat me u ndarë në bazë të pronarit. Ka një pronarë që ka 2-3 prona dhe i ndajmë sipas pronarëve, për me ditur se çka merr dhe çka jep komuna, se kemi raste kur ofrohen 2-3 prona të një pronari për me marrë ndonjë pronë tjetër. Kur të iu vjen lënda, e specifikojmë sipas pronarit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** I të njëjtit mendim jam edhe unë, se mundemi me një zonë kadastrale me i pasur 3 kërkesa. I pyesim të gjitha subjektet politike.

**Nënkryetari i Komunës:** Edhe unë jam i pajtimit që të ndahen lënda sipas kërkesave të pronarëve.

**znj. Ardita Rrahmani:** Edhe unë pajtohem.

**z. Kjani Zeneli:** Pajtohem plotësisht me mendimin e drejtorit. Në KPF po i shqyrtojmë me një pikë të përbashkët këto prona, ndërkaq në mbledhje të KK i shqyrtojmë të veçanta.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Edhe ne kemi ekspertë nga jashtë dhe diskutojmë me ta, por janë qytetarët e komunës të cilët i ndjekin seancat dhe kërkojnë shpjegime, se ne nuk mundemi ne me i dhënë sqarime secilit qytetar veç e veç. Është mirë me na shpjeguar drejtori edhe në seanca të KK, se ato foto nuk e di a janë në faqe të komunës. Në momentin kur shpjegohen e prezantohen shpallja e interesit të këtyre pronave, qytetarët i kanë me të qarta se për çka po debatojmë. Pajtohem plotësisht me Kjanin se duhet një shpjegim me i qartë i shpalljes së këtyre pronave me interes.

**z. Bashkim Krasniqi:** Edhe unë jam i pajtimit që në KK lënda të vjen e ndarë veç e veç sipas pronarëve.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Nuk po e kuptoj pse mos me u diskutuar veç e veç në KK, kur dihet se janë 15 pika. Nuk e kuptova drejtorin që tha me u shqyrtuar në KK pronat në bazë të pronarëve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në KK kanë me qenë të veçanta, ndërkaq e përbashkëta janë në KPF.

**z. Korab Krasniqi:** Fjala vjen, e kemi një pronar, Afrim Shabani që ka prona komunale në ZK në Kotlinë dhe në ZK në Ivajë, kështu që për pronën e tij, pika të bëhet në emër të pronarit, d.m.th. brenda një pike me qenë të gjitha pronat e atij pronari.

**Nënkryetari i Komunës:** Nuk do të thotë që ka me pasur shumë prona të një pronari.

**z. Korab Krasniqi:** Ne kemi pasur shumë kërkesa, i kemi aprovuar 15 që kanë qenë me të arsyeshme dhe për interes publik. Nëse këto 15, nëse ka ndonjë reagim që nuk duhet me i mbështetur, ne nuk aprovojmë, se nuk jemi të interesuar me krijuar konflikt, por me bërë zgjidhje.

**znj. Ardita Rrahmani:** Për hera tjera, a po mbetet që lëndë të kësaj natyre me ardhur edhe në KPF, veç e veç.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Po gjithsesi. Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë, me propozimin që për KK me u ndarë kjo pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Konstatohet se KPF,

**Aprovoj**

**Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK, Begracë, Kaçanik, Nikaj, Elezaj, Kotlinë dhe Ivajë,**

**I rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim, si pika të ndara, të cilat do të përgatiten nga DUKMM.**

**3. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2024:**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtori është këtu, ia kalojmë fjalën:

**z. Valdrin Dogani:** Materialin e keni marrë, është një raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në pasqyrat financiare për vitin 2024. Raporti është për vitin 2024, në bazë të rregullores së ZKA, që neve na lejon me bërë vlerësimin për rekomandimet që janë dhënë, se a janë zbatuar apo janë pjesërisht të zbatuara. Po e bëjë një kronologji të afateve, deri me 31 janar e kemi obligim me paraqitur raportin financiar. Brenda 90 ditëve pas dorëzimit, duhet ZKA, me paraqitur një raport për organizatën tonë buxhetore, se a kemi vepruar mirë apo jo. Dje na ka ardhur raporti i auditimit, brenda 30 ditëve, deri me 1 maj, ne duhet me paraqitur planin e veprimit. Se çka kemi me bërë me i zbatuar ato rekomandime, pastaj është data 15 shtator, është e cekur në shkresë, kur ne e vlerësojmë vetën se a i kemi zbatuar ato rekomandime. Data 15 mars është afati i parë, që po i bien se ende nuk e kemi pranuar raportin e auditorit për vitin 2025, po raportojmë për vitin 2024. Rregullorja është në internet, mundeni me i pa qysh janë këto procedura, që na obligon neve me i raportuar dy herë në vit KK deri me 30 shtator dhe 15 mars.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**znj. Kadrije Lika Troni:** A jemi në kohë për shqyrtimin e këtij raporti të vitit 2024?

**z. Valdrin Dogani:** Po, jemi brenda afatit.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Nga 12 gjetje si në raport, 2 janë zbatuar plotësisht, 7 pjesërisht, 3 të pazbatuara. Gjetjet janë të inspektimi i pronave në tatim, menaxhimi i kontratave në e-prokurim, menaxhimi i llogarive të arkëtuara. Të inspektimi i pronave, a e ka shkelur ligjin komuna në këtë rast që është i pazbatuar ky rekomandim? Pse kontratat kapitale vazhdojnë të lidhen pa buxhet të mjaftueshëm, që me krijuar obligime të pambuluara komunës, kur nuk i ka mjetet? Projektet kapitale vonohen deri 524 ditë pa u marrë masa ndaj operatorit. A ka ndonjë masë që u marrë ndaj operatorëve për vonesa të tilla?

**z. Valdrin Dogani:** Të tatimi në pronë shënohet me i ri inspektuar 20% të tyre, por në mungesë të stafit dhe sfidave, e kam shënuar që ka qenë e pamundur. Të kontratat e lidhura pa pasur buxhet, ju e dini që bartja e të HVK vonon. Ligji nuk i parasheh të HVK të bartura, ndërkaq ne gjithmonë llogarisim këto të hyra për me lidhur kontrata. Bartjen e mjeteve kemi me pasur në mbledhje të KK. Me bartjen e mjeteve, mendojmë diku 50 % të kontratës së lidhur, me e realizuar.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Nga 2 rekomandimet e zbatuara plotësisht, po i bien se janë zbatuar diku 20 % e rekomandimeve, 7 janë pjesërisht, 3 të pazbatuar. Unë këtu shoh një mundësi të organizimit të punëve të nivelit lokal.

**z. Valdrin Dogani:** Ashtu e shihni ju, ndërkaq niveli është bukur i lartë i angazhimit, janë 7 rekomandime pjesërisht të zbatuara- që nuk është numër i pakët, 3 rekomandime janë të pazbatuara.

**Nënkryetari i Komunës:** Të tatimi në pronë, ne çdo herë kemi pasur mundësi të arkëtimit, në mundësi të stafit.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Për atë unë po them se ka mundësi të organizimit të punëve në komunë.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Nuk po me pëlqen përgjigja, se duhet me bërë organizimin e stafit, që me u bërë ky rekomandim i zbatueshëm, e jo me mbetur sa herë i pazbatuar.

**Nënkryetari i Komunës:** Gjendja është kjo që kemi, në momentin që kemi marrë 2 punëtorë, është realizuar 100%, por punëtorët kanë kaluar në vende tjera të punës.

**z. Valdrin Dogani:** Raporti është real. Nëse nuk gaboju, në planin e punës së DBF, e kam shënuar se duhet me gjetur një kompani me realizuar inspektimin e pronave. Shumica e komunave e kanë këtë gjetje, në mundësi të stafit. Mundësi me e mirë është punësime me konkurs.

**z. Kjami Zeneli:** Raporti është i hartuar mirë nga DBF, ndërkaq kërkoj qartësi të pagesa e projekteve në kundërshtim me buxhetin të A2. Pse janë bërë këto pagesa në kundërshtim me ligjin?

**znj. Ernesta Krasniqi:** Edhe në vitin e kaluar ka qenë kjo gjetje, për blerjen e pajisjeve për QKMF.

**z. Valdrin Dogani:** Një nga sfidat e zbatimit të plotë të këtij rekomandimi, ka qenë, ndikimi financiar i obligimeve që kanë rrjedhë nga kontrata kolektive. Ne i kemi pasur mjetet për realizimin e atij projekti, por ka ndërhyrë thesari, na i ka marrë mjetet, tani operatori i kërkon mjete për punën e kryer. Nëse nuk i shpenzojmë, mjetet kthehen në suficit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim me ia përcjellë KK dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Konstatohet se KPF, Diskutoj

**Raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2024. Ky raport i kalohet KK të komunës në procedurë të shqyrtimit.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:50. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët 07.

Mbledhja e III (tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës e vitit 2026 e legjislaturës së 8, do të mbahet me 30.03.2026 (e hënë) në ora 11:00.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit  
Selajdin Troni



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

### Zyra e Kryetarit

01-Nr. 104/02-8821/26  
Kaçanik 16.04.2026

Në mbështetje të neneve 11, 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d) dhe 47 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 5 paragrafi 5.2 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 043/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009 si dhe duke pasur parasysh nenin 33 të Rregullores së Punës së Kuvendit, kryetari i komunës, jep këtë:

### PROPOZIM

Që Komiteti për Politikë dhe Financa , në mbledhjen e radhës më \_\_\_\_\_ të shqyrton dhe aprovon duke e proceduar për procedura të mëtejme në Kuvend të Komunës, pikën e rendit të ditës:

### VEDNIM

#### Për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPK “Stacioni i Autobusave” SH.A – Kaçanik

I. Komisioni Komunal i Aksionarëve, për Ndërmarrjen Publike Komunale “Stacioni i Autobusave” SH.A – Kaçanik, në përputhje me ligjet në fuqi, do t'i ketë 3 anëtarë: 1 (një) anëtar i emëruar nga kryetari i komunës dhe dy anëtarë të tjerë të emëruar nga kuvendi i komunës.

II. Përbërja e Komisionit Komunal të Aksionarëve, do të jetë:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_ dhe
3. \_\_\_\_\_

III. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës.

V. Ky vendim hynë në fuqi pas aprovimit në kuvend.

VI. Me këtë vendim do të njoftohen: Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve, NPK “Stacioni i Autobusave” SH.A – Kaçanik dhe Arkiva.



Sabedin VISHI  
Kryetar i Komunës



01.Nr. 104/02-8864  
Datë 16.04.2026

Në mbështetje të nenit **58**, shkronja (h ) të Ligjit NR.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), si dhe të nenit **24** dhe nenit **25** të Ligjit nr. 06/I-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni **29**, paragrafi **5** të rregullore (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni **6** pika **2** shkronja (h ) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm , Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit që Kuvendi i Komunës , në mbledhjen e radhës të merre këtë :

**PROPOZIM VENDIM  
PËR SHPALLJE NË INTERES PUBLIK TË PARCELAVE KADASTRALE NË ZK.  
KAÇANIK I VJETËR**

- I.** Kuvendit të komunës për miratim të vendimit për shpallje të parcelave me interes publik të pronës së paluajtshme në **ZK. KAÇANIK I VJETËR**, me pronësi të personit Juridik.
- II.** Sipas propozimit të cekur në piken -I- të këtij propozimi, lidhje me shpalljen e interes publik të parcelave të pronës si vijon:

Parcela Kadastrale P-70917086-02301-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej  $S= 44391 m^2$ , në pronësi të personit Juridik "KIVO" L.L.C, me numer personal 71050378, me vendodhje në Fsh. Kaçanik i Vjetër, ZK Kaçanik i Vjetër. (të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe  $1273m^2$ , e cila nevojitet për krijimin e një rruge të re).

**Arsyetim**

Propozimi për iniciimin e për shpallje të parcelave me interes publik të pronës së paluajtshme Në ZK, Kaçanik i Vjetër me pronësi private të personit Juridik u propozua me qëllim që të krijohet mundësi për krijimin e një rruge të re dhe këmbim të parashtruar sipas kërkesës së palës me nr të protokollit 01-060/01-7624/26 të datës 02.04.2026.

Nga të theksuarit si më lartë u propozua për miratim si në dispozitiv të këtij Propozim – Vendimi

Kryetari i Komunës  
z. Sabedin Vishi





Innovation is our motivation

**KOMUNES SË KACANIKUT**  
**KUVENDIT KOMUNAL**  
**Kryesuesit**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPËSTINA KAÇANIK



Data	02.04.2026	Vendi	Kaçanik
Nj. org.		Numri	
	01-060/01	Shtojcë	7624/26

**Kaçanik**

**Nga:** Shoqëria Tregtare **KIVO L.L.C.** e cila gjendet me lokacion në Kaçanik, magjstralja Kaçanik-Ferizaj, km.14, me NUI 811233634 përfaqësuar nga Driton Ramajli Ramajli, Parashtruesi i kërkesës.

**Lënda:** Kërkesë për ndërrim të sipërfaqes së tokës ndërmjet Komunës dhe KIVO L.L.C. sipas elaboratit kadastral të propozuar

**Data:** 01.04.2026

I nderuar Zoti Selajdin Troni

Shoqëria Tregtare **KIVO L.L.C.**, pronare e njësisve kadastrale nr. 02287-0 dhe 02301-0 të cilat ndodhen në Zonën Kadastrale Kaçaniku i Vjetër dhe të cilat janë krijuar përmes bashkimit të disa parcelave më të vogla, me këtë kërkesë i drejtohet Kuvendit të Komunës për shqyrtimin dhe miratimin e **ndërrimit të sipërfaqes së tokës ndërmjet Komunës dhe KIVO L.L.C.**, sipas elaboratit kadastral të përgatitur nga kompania e licencuar e gjeodezisë.

Ndërmjet dy njësisve kadastrale në pronësi të KIVO L.L.C. ekziston një **rrugë publike, prone shoqërore, e pa kategorizuar**. Kjo rrugë historikisht është shfrytëzuar ekskluzivisht vetëm për qasje të parcelave kadastrale të cilat, pas blerjes nga KIVO, janë bashkuar në njësite kadastrale nr. 02287-0 dhe 02301-0, Zona Kadastrale Kaçaniku i Vjetër dhe nuk ka funksion publik për qarkullim të përgjithshëm. Aktualisht, njësitë kadastrale në pronësi të KIVO L.L.C. janë të konsoliduara dhe përbëjnë një kompleks unik industrial, ndërsa rruga në fjalë e ndan fizikisht pronën dhe pamundëson zhvillimin e plotë të aktivitetit ekonomik.

Për këtë arsye, KIVO L.L.C. ka iniciuar përgatitjen e **elaboratit kadastral për ndërrim të sipërfaqeve**, i cili parashihet që:

- sipërfaqja e një pjese të rrugës së pa kategorizuar si pronë shoqërore të kalojë në pronësi të KIVO L.L.C.;
- ndërsa kompania KIVO L.L.C. t'i kalojë Komunës në pronësi një sipërfaqe tjetër toke nga njësitë kadastrale nr. 02301-0;
- sipërfaqet janë të barabarta, respektivisht KIVO L.L.C. i jep Komunës disa metra katrorë më tepër dhe nga kjo rrethanë edhe konsiderojmë se nuk është i domosdoshëm vlerësimi I vlerës së sipërfaqeve të paluajtshmerive që po ndërrohen;
- ndërrimi nuk e dëmton interesin publik dhe nuk pengon qasjen të pronave përreth.



*Innovation is our motivation*

## Arsyetimi i kërkesës

Ndërrimi i sipërfaqes së tokës është i nevojshëm për këto arsye:

1. Mundëson zhvillimin e rregullt të aktivitetit ekonomik të KIVO L.L.C.;
2. Krijon mundësi për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese dhe investime të reja industriale;
3. Lejon rrethimin e tërë kompleksit industrial me një rrethojë unike, duke rritur sigurinë dhe kontrollin e hapësirës;
4. Përmirëson organizimin funksional të kompleksit dhe qasjen logjistike;
5. Rruga ekzistuese nuk ka funksion publik dhe ajo aktualisht nuk shfrytëzohet nga askush, por ekzistenca e saj si pronë shoqërore pengon bashkimin e dy parcelave dhe realizimin e projekteve të zhvillimit të KIVO-s.

## Përfitimet publike për Komunën

Ky ndërrim sjell përfitime të drejtpërdrejta për Komunën dhe komunitetin, si:

- rritje të kapaciteteve prodhuese dhe zhvillim ekonomik lokal;
- hapje të vendeve të reja të punës për qytetarët e komunës;
- rritje të të hyrave komunale nga taksat dhe tarifat komunale;
- pagesa e taksave për leje ndërtimore për objektet e reja që do të ndërtohen;
- rritje e investimeve dhe zhvillimit industrial në zonë;
- shfrytëzim më racional i pronës shoqërore dhe pjesa që merr komuna në pronësi mund të integrohet më mirë në rrjetin ekzistues të qasjes dhe infrastrukturës rrugore.

Kompania KIVO është e gatshme të bashkëpunojë me Komunën në çdo fazë të procedurës dhe të sigurojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe teknik për realizimin e këtij ndërrimi.

## Bashkëngjitur:

1. Elaborati kadastral për ndërrim të sipërfaqeve
2. Certifikatat e pronësisë me kopje të planit
3. Dokumente të tjera relevante

Duke marrë parasysh interesin ekonomik dhe publik, ju lutemi që kërkesa të shqyrtohet dhe të iniciohen procedurat ligjore për miratimin e ndërrimit të njësive kadastrale ndërmjet Komunës dhe KIVO L.L.C.

Me respekt,

Për dhe në emër të KIVO L.L.C.



Driton Ramajli, Drejtor Menaxhues



## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria e Kosovës- Vlada Kosova- Government of Kosovo

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/ Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/ Ministry of Infrastructure and Environment

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA/ KOSOVO CADASTRAL AGENCY

### PROCESVERBALI NGA TERRENI

Gjeodeti / Kompania gjeodete e licencuar: **Geoproject** Numri i licencës: **7**

Komuna: **Kaçanik** Zona Kadastrale: **Kaçanik i vjetër**

Numri i njësisë kadastrale: **1251-0 dhe 2301-0**

Matja/piketimi është realizuar me:	
GPS/GNSS	<input type="checkbox"/>
Stacion Total	<input type="checkbox"/>

#### 1. Përshkrimi i procesit

Kërkesë për rregullimin e skicës për këmbimin e pjesëve të parcelave

Kompania "KIVO" L.L.C paraqet kërkesë për rregullimin e skicës lidhur me këmbimin e një pjese të parcelës nr. 2301-0, në pronësi të kompanisë, me një pjesë të parcelës nr. 1251-0, në pronësi të P.SH.Rrugët publike dhe të pa kategorizuara, me qëllim harmonizimin me gjendjen faktike të shfrytëzimit në terren.

Sipas propozimit:

Parcela nr. **2301-0** (pronë e "KIVO" L.L.C) i jep rrugës sipërfaqe prej **1273 m<sup>2</sup>**;

Në këmbim, kompania përfiton **1175 m<sup>2</sup>** nga parcela nr. 1251-0, në të njëjtën zonë kadastrale.

Qëllimi kryesor i këtij këmbimi është lehtësimi i funksionimit të veprimtarisë së kompanisë, si dhe përmirësimi i qarkullimit të qytetarëve në rrugën e cila aktualisht shfrytëzohet sipas gjendjes faktike në terren.

Me këtë rast, lusim Kuvendin Komunal të Kaçanikut që të shqyrtojë dhe të miratojë këtë propozim.

Nënshkrimi dhe vula e gjeodetit:


Data: 24.03.2026



Republika e Kosovës

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit / Ministarstvo Infrastrukture i Zhvotnu  
Sredina / Ministry of Infrastructure and Environment

AGENCIJA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA



## SITUACIONI I TERENIT

**Parshtruesi i Kerkeses: "KIVO" L.L.C.**

**Pjesa e parcelës 1863-0 Zona Kadastrale Kaçanik i vjetër**

**Parcelat : 1251-0 dhe 2301-0**

**Shkalla e zvoglimit : 1:2000**

Lista e koordinatave të pikave të matura:

Nr	X	Y	Z	Nr	X	Y	Z
1	7517687.338	4684871.548	0	29	7517817.155	4684513.859	0
2	7517694.538	4684873.718	0	30	7517814.415	4684506.8	0
3	7517696.928	4684865.398	0	31	7517785.105	4684515.36	0
4	7517717.667	4684853.098	0	32	7517735.406	4684530.952	0
5	7517740.397	4684828.588	0	33	7517687.386	4684540.993	0
6	7517725.836	4684803.71	0	34	7517656.027	4684557.724	0
7	7517748.275	4684793.699	0	35	7517652.028	4684558.224	0
8	7517579.915	4684789.389	0	36	7517650.675	4684583.597	0
9	7517766.605	4684785.959	0	37	7517654.437	4684582.103	0
10	7517803.725	4684772.468	0	38	7517661.279	4684612.341	0
11	7517860.544	4684754.237	0	39	7517656.494	4684612.914	0
12	7517863.614	4684751.946	0	40	7517663.093	4684640.97	0
13	7517876.394	4684741.876	0	41	7517667.89	4684640.5	0
14	7517873.663	4684731.067	0	42	7517670.601	4684684.968	0
15	7517853.673	4684724.528	0	43	7517665.96	4684685.789	0
16	7517826.322	4684714.779	0	44	7517667.929	4684731.187	0
17	7517826.322	4684707.5	0	45	7517671.663	4684721.846	0
18	7517820.612	4684690.981	0	46	7517678.194	4684772.033	0
19	7517890.001	4684682.851	0	47	7517683.335	4684809.177	0
20	7517825.811	4684666.372	0	48	7517678.175	4684809.886	0
21	7517818.27	4684659.313	0	49	7517683.766	4684812.281	0
22	7517815.459	4684622.464	0	50	7517685.458	4684858.159	0
23	7517814.489	4684610.965	0	51	7517655.637	4684563.711	0
24	7517819.308	4684594.155	0	52	7517689.109	4684545.741	0
25	7517815.817	4684566.377	0	53	7517796.669	4684535.796	0
26	7517814.077	4684551.758	0	54	7517786.554	4684520.146	0
27	7517813.926	4684542.698	0	55	7517808.699	4684515.007	0
28	7517815.746	4684525.659	0				

### Shpjegues:

- Kufiri kadastral (nga SIKTK-G)
- Kufiri i ri ndares i propozuar
- Siperfaqja e kerkuar per kembim

Rilevoi / Snimio: GEOPROJECT


(emri, mbiemri i gjedetit/kompanise/ imsi, prezime geodeta/ kompanije)

Data e rilevimit / Datum snimipaja: 05.03.2026

Nr. i licencës / Br. licence: 117

Ndëshkrimi / Potpis:

117





Republika e Kosovës  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit / Ministarstvo Infrastrukture i Zivotnu  
Sredinu / Ministry of Infrastructure and Environment  
AGENCIJA KADASTRALNE E KOSOVËS / KATASTRANSKA AGENCIJA KOSOVA



## SITUACIONI I TERENIT

Parshtruesi i Kerkeses: "KIVO" L.L.C.

Pjesa e parcelës 1863-0 Zona Kadastrale Kaçanik i vjetër

Parcelat : 1251-0 dhe 2301-0

Shkalla e zvoglimit : 1:2000

Lista e koordinatave të pikave të matura:

Nr	X	Y	Z	Nr	X	Y	Z
1	7517697.338	4684871.548	0	29	7517817.155	4684513.859	0
2	7517694.538	4684873.718	0	30	7517814.151	4684506.8	0
3	7517696.928	4684865.398	0	31	7517785.105	4684515.36	0
4	7517717.667	4684853.098	0	32	7517735.406	4684530.952	0
5	7517740.397	4684828.588	0	33	7517687.386	4684540.993	0
6	7517725.836	4684803.71	0	34	7517656.037	4684557.724	0
7	7517748.275	4684793.699	0	35	7517652.028	4684558.224	0
8	751757.915	4684789.389	0	36	7517650.675	4684583.597	0
9	7517666.605	4684785.959	0	37	7517654.437	4684582.103	0
10	7517803.725	4684772.468	0	38	7517661.279	4684612.341	0
11	7517860.544	4684754.237	0	39	7517656.494	4684612.914	0
12	7517863.614	4684741.876	0	40	7517663.093	4684640.97	0
13	7517876.394	4684741.876	0	41	7517667.39	4684640.5	0
14	7517873.663	4684731.067	0	42	7517670.601	4684684.968	0
15	7517863.865	4684724.528	0	43	7517665.96	4684685.789	0
16	7517853.673	4684714.779	0	44	7517667.929	4684731.187	0
17	7517826.322	4684707.5	0	45	7517671.663	4684721.846	0
18	7517820.612	4684690.981	0	46	7517678.184	4684772.033	0
19	7517820.001	4684682.851	0	47	7517683.335	4684809.17	0
20	7517825.811	4684666.372	0	48	7517678.175	4684809.886	0
21	7517818.27	4684639.313	0	49	7517683.766	4684812.281	0
22	7517815.459	4684622.464	0	50	7517685.458	4684858.159	0
23	7517814.489	4684610.965	0	51	7517655.637	4684563.711	0
24	7517819.308	4684594.155	0	52	7517689.109	4684545.741	0
25	7517815.817	4684566.377	0	53	7517736.669	4684535.796	0
26	7517814.077	4684551.758	0	54	7517786.554	4684520.146	0
27	7517813.926	4684542.698	0	55	7517808.699	4684515.007	0
28	7517815.746	4684525.659	0				

### Shpjegues:

- Kufiri kadastral (nga SIKTK-G)
- Kufiri i ri ndares i propozuar
- Siperfaqja e kerkuar per kembim

Rilevoi / Snimio: GEOPROJECT


(emri, mbiemri i gjetestr/kompanise/ imes, prezime geodeta/ kompanije)

Data e rilevimit / Datum snimanja: 05.03.2026

Nr. i licencës / Br. licence: NZ

Nënshtkrimi / Potpis:

V.V.





## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /  
Ministry of Environment and Spatial Planning  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

### CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

**NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917086-02301-0**

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 7335/2026

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 30.03.2026 - 15:26

Komuna / Opština / Municipality: KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kaçanik I Vjetër / Stari Kaçanik / Kaçaniku I Vjetër

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK

#### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917086-02301-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna imovina / Privately owned Land	Rural	44391		21.02.2022	21.02.2022

#### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
LIVADHET E MALOKIT-KALISHTE	0		21.02.2022	21.02.2022



**A.2 LLOJII SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE**

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Bujqësore/Pojoprivredno/Agriculture	Livadh/Livade/meadow	Livadh I Klasës 3/Livada 3 Klasse/3rd Class Meadow	2108
1	Bujqësore/Pojoprivredno/Agriculture	Livadh/Livade/meadow	Livadh I Klasës 4/Livada4 Klasse/4th Class Meadow	1489
1	Bujqësore/Pojoprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 5/Njiva 5 Klasse/5th Class Arable Land	35203
1	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemijiste/Construction land	Oborr/Dvorište/Back Yard		994
2	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemijiste/Construction land	Shtrëpi-Ndërrese/Kuca-Zgrada/House-Building		262
1	Bujqësore/Pojoprivredno/Agriculture	Livadh/Livade/meadow	Livadh I Klasës 5/Livada 5 Klasse/5th Class Meadow	4335

**B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR**

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	"KIVO" L.L.C.	71050378	Kaçaniku i Vjeter / Kačaniku i Vjeter / Kačaniku i Vjeter /			1/1	2211/2018	14.03.2022



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA  
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY  
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kaçanik i vjetër

7335/16

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-70917086-02301-0	Parcelë / Parcela / Parcel	44391



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2833



Punoi/Obradio/Created: Visar Mulaku

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 30.03.2026

Koha/ Vreme/ Time: 03:25:36